




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
FAKULTETI I EKONOMISË  
DEPARTAMENTI I FINANCËS DHE KONTABILITETIT



Nr. 05/4 prot.

Vlorë, më 11.02 .2019

**Lënda:** Propozim i sistemit të vlerësimit të dosjeve të kandidatëve për personel akademik me angazhim me kohë të plotë në Departamentin e Financës dhe Kontabilitetit, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

**Drejtuar:** Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë  
Prof. Dr. Albert Qarri

Bazuar në përcjelljen e shkresës me nr 84/4 Prot, datë 08.02.2019 nga Dekani i Fakultetit të Ekonomisë me nr 05/2 Prot., datë 08.02.2019, bazuar në urdhrin nr. 6 datë 07.02.2019 "Për ngritjen e komisionit ad- hoc për vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për personel akademik me angazhim me kohë të plotë, në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë", pika 3, të Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 64 "Punësimi i personelit akademik", pika 1, bazuar në Nenin nr. 44 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë si dhe në pikën 3 të nenit 29 të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, bazuar në mbledhjen e datës 11.02.2019 me këtë temë në Departamentin e Financës dhe Kontabilitetit, propozojmë sistemin e vlerësimit të dosjeve të kandidatëve si më poshtë vijon:

Në fazën e parë bëhet vlerësimi me pikë duke ju referuar rezultateve të shkollimit për çdo diplomë që zoteron kandidati, eksperiencës në mësimdhënie, aktivitetit shkencor, studimeve të ciklit të tretë, gradës shkencore dhe titujve akademikë dhe titujve të tjerë profesionalë si më poshtë:

1. Rezultatet e shkollimit për çdo diplomë në IAL në Shqipëri:

- Për diplomën "Bachelor" 0,5 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9 -10.
- Për diplomën "4-vjeçare" 0,75 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
- Për diplomën "5-vjeçare" 1 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
- Për diplomën "Master i Shkencave" apo "Master i Nivelit të Dytë" 0.5 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.

2. Rezultatet e shkollimit për çdo diplomë të fituar në universitetet perëndimore:

- Për diplomën "Bachelor" 0,75 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE**  
**FAKULTETI I EKONOMISË**  
**DEPARTAMENTI I FINANCËS DHE KONTABILITETIT**

- Për diplomën “4-vjeçare” 1 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
- Për diplomën “5-vjeçare” 1,5 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
- Për diplomën “Master i Shkencave” 0,75 pikë për çdo 1/10 të notës mesatare në intervalin 9-10.
- 3. Eksperienca në mësimdhënie në IAL në Shqipëri:
  - Me kohë të plotë 1 pikë për çdo vit pune, por jo me më shumë se 5 pikë në total.
  - Me kohë të pjesshme 0,5 pikë për çdo vit pune, por jo me më shumë se 2 pikë në total.
- 4. Aktiviteti shkencor:
  - Botime në revista shkencore ndërkombëtare me faktor impakti 5 pikë çdo artikull.
  - Botime në revista shkencore ndërkombëtare me bord editorial 2 pikë çdo artikull.
- 5. Grada Shkencore dhe tituj akademikë:
  - Doktor i Shkencave 50 pikë.
  - PhD në universitetet perëndimore apo Profesor i Asociuar 70 pikë.
  - Profesor i Asociuar 100 pikë,
  - Profesor Doktor 150 pikë
- 6. Komisionet ad-hoc janë përgjegjëse për respektimin e kriterëve dhe për procedurën e konkurimit. Këto komisione në çdo rast kanë të drejtë të kërkojnë dokumentacion shtesë për vërtetësinë e dosjes dhe të deklarimeve.
- 7. Në fazën e dytë, bëhet vlerësimi me pikë duke iu referuar intervistës me gojë e cila vlerësohet në intervalin nga 1-10 pikë.

**Drejtuese e Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit**  
Prof.As. Dr Filloreta Madani



Ky dokument përpilohet në 3 (tre) kopje